

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative ,me gjyqtaren, Lirije Maksutaj dhe sekretaren juridike Mana Gjinaj, në konfliktin administrativ të paditëses, F.M., , K.V., kundër të paditurës Qeveria e Kosovës-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë-Departamenti i Mirëqenies Sociale, Prishtinë, baza juridike anulimi i aktvendimit të MPMS-DMS, në seancën e shqyrtimit kryesor publik, të mbajtur në prani të paditëses e në mungesë të paditurës, me dt.11.11.2015, merr këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesëpadia e paditëses, F.M., anulohet aktvendimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Mirëqenies Sociale me numër prot.084, të dt.23.05.2013 dhe çështja i kthehet të paditurës në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m i

Paditësja, F.M., si me padinë e ushtruar me dt.23.07.2013, por edhe ne deklarin e saj ne seancën e shqyrtimit kryesor te dt.11.11.2015, ka kërkuar nga gjykata që të anulohet aktvendimi i MPMS/DMS me Nr.prot.084, të dt.23.05.2013, lënda të kthehet në rishqyrtim të paditurës sepse aktvendimi i atakuar është në kundërshtim me ligjin për Përkrahje të Familjeve me Fëmijë me aftësi të Kufizuar. Paditësja ka deklaruar se të djali i saj, A. aftësia e ë kufizuar eksiton dhe se duhet të kujdeset për gjatë gjithë kohës andaj, konsideron se i takon e drejta për përkrahje materiale dhe kompensim. E njëjta ka shtuar se para komisionit ka prezantuar provat por se komisioni i ka refuzuar këtë të drejtë padrejtësisht duke ia mohuar të drejtën në përkrahje materiale për kujdesin ndaj fëmijës me aftësi të kufizuar të përhershme.

Përfaqësoja e te paditurës është ftuar në mënyrë të rregullt për seancën e datës 11.11.2015, por në seancë nuk ka prezantuar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, andaj, gjykata konform nenit 41.par 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, e ka mbajtur shqyrtimin kryesor pa praninë e të paditurës.

E paditura, në përgjigjen në padi dt.30.03.2015 e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar. Ka theksuar se paditësja nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për të ia njohur e drejtën në përkrahje materiale për kujdesin ndaj fëmijës me aftësi të kufizuar të përhershme. Se e paditura e ka marrë vendimin e atakuar duke u bazuar në vlerësimin e komisionit vlerësues mjekësor i përbërë nga specialistë të fushave përkatëse, andaj në bazë të Ligjit Nr. 03/L-022, kjo e drejtë nuk i takon paditëses. Prandaj i ka propozuar gjykatës që ta refuzojë padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i atakuar.

Gjykata në seancën e dt. 11.11.2015, ka bërë administrimin e provave dhe atë: lexohet përgjigja në padi e dt. 30.03.2015, aktvendimi i MPMS-DMS/DSHS me nr. të dosjes 084 i dt. 23.05. 2013, raporti konsular i QKUK i dt. 11.07.2013 si dhe lexohet fletë lëshimi i QKUK me nr.amzë 10180.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Nga vendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par.2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbaj përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti, etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 të po të njëjtit ligj, parashihet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtën dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar, etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Gjykata duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të goditur me padi ka konstatuar se i njëjti është juridikisht i pa çart, kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se duke vepruar sipas ankesës së paditëses në mënyrë të gjithanshme në seancën e vet të datës 23.05.2013, i ka shqyrtuar shkresat e lëndës, pretendimet ankimore, dokumentacionin mjekësor, që gjendet në lëndë dhe vlerësimin e Komisionit Mjekësor të shkallës së parë dhe ka konstatuar se nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të qenë shfrytëzuese e të drejtës, sipas Ligjit Nr.03/L-022 për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme, me ç ‘rast e refuzon ankesën si të pabazuar dhe vërteton vendimin e shkallës së parë.

Nga aktvendimi i MPMS/DMS/DSHS shihet se paditëses i është refuzuar ankesa “ bazuar në vlerësimin e Komisionit mjekësor, i cili e ka vlerësuar aftësinë e kufizuar të fëmijës së ushtrueses së kërkesës dhe ka ardhur në përfundim se të fëmija aftësia e kufizuar e përhershme nuk ekziston”.

Edhe pse në aktvendimin e goditur me padi thuhet se para komisionit në shkallë të dytë të mbajtur në seancën mjekësore të dt.23.05.2013 pas shqyrtimit të raporteve mjekësore si, flet lëshimi me epikrizë i QKUK, Klinika e pediatriisë shërbimi i neurologjisë nr.i amzës, 3790, mjekuar nga dt.27.09.2011 deri me dt.03.10.2011, raportit të klinikes psikiatrike të QKUK-së

dt.26.09.2012 si dhe shkresave tjera te lendes, Komisioni Mjekësor ka ardhur ne përfundim për të refuzuar kërkesën e paditëses për djalin e saj A., sepse i njëjti nuk e ka aftësinë e përhershme të kufizuar prandaj e drejta në përkrahje materiale për kujdesin ndaj fëmijës me aftësi të kufizuar nuk i takon. Megjithatë edhe pse e paditura pretendon se i ka administrua provat dhe ka dhënë përgjigje për padinë e njëjta edhe pse e ka obligim ligjore që se bashku me përgjigje ti bashkëngjisë provat mbi bazën e të cilave është arsyetuar vendimi i goditur dhe është refuzuar ankesa, e njëjta kësaj gjykate nuk ja ka bashkangjitur provat. Prandaj nga aktvendimi i goditur padi dhe në mungesë të provave që e paditura nuk i ka dorëzuar kësaj gjykate, kjo e fundit nuk ka mundur të konstatoj nëse është respektuar procedura para Komisionit Mjekësor në shkallë të parë dhe dytë dhe si ka ardhur deri të përfundimi i komisionit mjekësor se ankuesi nuk i ka plotësuar kushtet për të qenë përfitues i të drejtës në bazë të nenit 23 të Ligjit për përkrahje familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme .

Gjykata në konfliktin administrativ vendos në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur me padi ne mungese te provave qe nuk janë bashkangjitur e paditura nuk mund të kuptohet si është vërtetuar kjo gjendje dhe nëse gjendja faktike është vërtetuar drejt.

Andaj, të metat e caktuara më lartë janë të atilla e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi ti mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur , duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2,3 lidhur me nenet 5,6 dhe 38 të LKS-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

A.nr.983/2013 e dt. 11.11.2015

Sekretare juridike
Mana Gjinaj

Gj y q t a r e
Lirije Maksutaj

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi është e

Lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të Njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.